



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-kline.org

Duke u mbështetur në nenin 12 paragrafi 12.1 dhe 12.2 nën d) si dhe nenit 40.1 dhe 40.2 nën l) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Nr.03/L-040, nenit 6 të Udhëzimit Administrativ, Nr.27/2012 MPB-03/2012 MAPL për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi, si dhe nenit 40 paragrafi 1 dhe 2 nën pikën e fundit të Statutit të Komunës së Klinës, Kuvendi i Komunës së Klinës në seancën e II-të të radhës për vitin 2019 të mbajtur më 28.02.2019 mori këtë:

V E N D I M

Për

Miratim të Planit të Punës së Këshillit Komunal të Sigurisë në Bashkësi për vitin 2019

I

Miratohet Plani i Punës së Këshillit Komunal të Sigurisë në Bashkësi për vitin 2019.

II

Pjesë përbërëse e vendimit është Plani i Punës për Këshillin Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) në Komunën e Klinës për vitin 2019.

III

Ky vendim hyn në fuqi pas miratimit nga Kuvendi i Komunës së Klinës dhe 15 ditë pas protokollimit në autoritetin mbikëqyrës sipas nenit 81 Ligjit të Vetëqeverisjes Lokale.

Me këtë vendim njoftohen: MAPL, Kryetari i Komunës, Zyra e Informimit, Shërbimi për Punë të Kuvendit dhe Arkivi i Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS KLINË

01Nr. 06-9003 2019
Klinë, më 05.03 2019

